

Nr. 675 prot
14.02.20



MARRËVESHJE
BASHKËPUNIMI AKADEMIK

mes

Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Shqipëri

dhe

Universitetit "Ukshin Hoti", Prizren

 Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizren "UKSHIN HOTI"	
Pranuar me dt.	02.03.2020
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
308	01-76

Duke u njohur me rëndësinë e shkëmbimeve në fushat e mësimdhënies dhe kërkimeve, po ashtu edhe mundësitë e siguruar nga forcimi i kontakteve mes anëtarëve të fakulteteve dhe studentëve të institucioneve, **Universiteti i Shkodrës dhe Universitetit "Ukshin Hoti", Prizren** nënshkruajnë marrëveshjen e mëposhtme në fushën e bashkëpunimit akademik.

Neni 1

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është inkurajimi i shkëmbimeve mes **Universitetit të Shkodrës dhe Universitetit "Ukshin Hoti", Prizren** në të gjitha fushat prezente në të dy universitetet.

Neni 2

Bashkëpunimi mes dy institucioneve respektive duhet të nxisë aktivitetet e mëposhtme:

- Shkëmbime dhe bashkëpunime reciproke të profesorëve, kërkuesve, studentëve dhe stafit tjetër në nivelin universitar dhe pas universitar;
- Organizimi i shkollave verore, seminareve dhe formave të tjera shkëmbimi njohurish nga palët;
- Shkëmbim literature, teksteve dhe publikimeve universitare;
- Realizimi i projekteve të përbashkëta;
- Shkëmbime eksperiencash në programe reciproke në fushën e sistemeve të informacionit dhe komunikimit;
- Shkëmbim stafi administrativ me qëllim përfitim eksperience dhe ndryshimeve të nevojshme;

- Bashkëpunimi në fushën e reformës universitare sipas Deklaratës së Bolonjës dhe Deklaratës së Lisbonës;
- Si dhe forma të tjera bashkëpunimi me qëllim që të jenë reciprokisht përfituese për të dyja palët.

Neni 3

Të gjitha aktivitetet e përmendura në Nenin 2 do të bazohen mbi reciprocitet.

Neni 4

Të dy Universitetet të paktën një herë në vit do bien dakort mbi format dhe fushat konkrete të bashkëpunimit. Këto programe të përbashkëta mund të ndryshohen dhe të amendësohen nga një marrëveshje e shkruar dhe e firmour nga të dyja palët.

Neni 5

Aktivitetet e përbashkëta do të rishikohen çdo vit.

Neni 6

Marrëveshja prezente nënshkruhet si një marrëveshje e vazhdueshme pa limite kohore.

Neni 7

Marrëveshja hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit të saj nga palët.

Neni 8

Secili Universitet ka të drejtë të propozojë aneksime dhe ndryshime të dokumentit në formë të shkruar dhe ndryshimet do fillojnë pas përshtatjes së tyre nga palët.

Neni 9

Secili Universitet ka të drejtë të ndërpresë marrëveshjen prezente duke paraqitur një lajmërim me shkrim të paktën gjashtë muaj para afatit.

Neni 10

Aktivitetet që nuk janë përfshirë në këtë Marrëveshje do akordohen nga palët, të cilat do vazhdojnë të kenë kontakte, vullnetin e mirë, fleksibilitetin dhe cilësinë e adaptueshme për realizimin e kësaj marrëveshjeje.

Neni 11

Kjo Marrëveshje do paraqitet në gjashte kopje identike (dy në gjuhën shqipe, dy në gjuhën serbe dhe dy në gjuhën angleze). Secili Universitet do marrë nje kopje (një kopje në secilën gjuhë).

Prof. dr. Agim Halsteshi



Prof. Asoc.Dr. Ismet Temaj



Data _____

Vendi _____